

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.07.09.2023*

**07.09.2023**

**Ora 17:04**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë” (BF),  
për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë  
Kukës të datës 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj**

**Parti Politike: Z. Fjoraldi Guri (Partia e Lirisë)**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, sot në rendin e ditës të kësaj seance publike kemi dy çështje: shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës dhe pika e dytë projektvendimi që ka të bëjë me caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për këto zgjedhje. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës me shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, si subjekt zgjedhor.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Neni 65 i Kodit Zgjedhor parashikon detyrimin që dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ. Bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, pranë KQZ– së janë regjistruar si subjekte zgjedhore”, për zgjedhjet e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.07.09.2023*

pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023 partitë si më poshtë vijon:

- Partia e Lirisë me kryetar zotin Ilir Metaj;
- Partia Demokristiane e Shqipërisë me kryetar zotin Nard Ndoka.

Në datën 6.09.2023, këto dy parti kanë paraqitur në zyrën e protokollit të KQZ-së, kërkesën për regjistrimin e koalicionit me emrin “Bashkë Fitojmë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023. Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.

Marrëveshja përmban:

- Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
- Formimin e koalicionit me emrin “Bashkë Fitojmë”;
- Shkronjat nistore të koalicionit “BF”;
- Siglën e koalicionit;
- Autorizimin e zotit Ilir Metaj, kryetar i partisë “Partia e Lirisë”/ ose të autorizuarin prej tij, të paraqesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ose KZAZ, kandidatët për kryetar bashkie në këtë njësi, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve, deri në përfundim të procesit zgjedhor;
- Partia udhëheqëse e koalicionit është “Partia e Lirisë”;
- Autorizimin e zotit Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
- Autorizimin e zotit Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.07.09.2023*

- Autorizimin e zotit Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ;

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton kushtet e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor.

- Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga dy ose më shumë parti politike.

- Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- dhe kushti i tretë është që këto parti duhet të jenë dy ose më shumë parti për të bërë koalicionin.


Në këtë kërkesë është kërkuar për të qenë pjesë e koalicionit Partia Demokratike me kryetar zotin Sali Berisha e cila nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor në këto zgjedhje. Në interpretim të dispozitës së mësipërme të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, parashikojmë se pjesë e koalicionit do të jenë dy parti, Partia e Lirisë dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të partive politike diskutime? Jo!

Mirë atëherë, vendosim regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” të përbërë prej partive politike të regjistruara tashmë si subjekt zgjedhor të Partisë së Lirisë dhe të Partisë Demokristiane, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, me shkronja nistore të Koalicionit BF dhe me siglën përkatëse të koalicionit sikurse e kanë prezantuar nëpërmjet partisë udhëheqëse të koalicionit Partisë së Lirisë.

**Vendimi nr. 765**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**
- **Parti Politike: Z. Fjoraldi Guri (Partia e Lirisë)**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Për numrimin e votave në KZAZ deri para ditës së votimit caktohen grupet e numërimit të votave. Neni 95 i Kodit Zgjedhor parashikon rregullat për përbërjen e grupeve të numërimit të votave. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga 4 antarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet sipas propozimit të partisë politike të cilit i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar sipas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa antari i tretë, propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe antari i katërt propozohet nga partitë e opozitës që kanë të drejtë të propozojnë antarin në KZAZ. Neni 96, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë antarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ nëpërmjet listës së partive politike të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.07.09.2023*

shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në zbatim të dispozitës së mësipërme do t'i referohemi rezultateve të zgjedhjeve dhe numrit të mandateve të partive politike për legjislaturën 2021-2025. Me vendimin numër 21, datë 13.07.2021, Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021. Numri i mandateve të fituara nga partitë politike është si më poshtë:

- Partia Socialiste ka 74 mandate;
- Partia Demokratike (Koalicioni Aleanca për Ndryshim) 59 mandate;
- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim 4 mandate;
- Partia Socialdemokrate 3 mandate.

Me shkresën e datës 24.01.2022, Kuvendi i Shqipërisë ka përcaktuar se partitë politike dhe numri i deputetëve për çdo parti politike janë konfiguruar si më poshtë vijon:

- Shumica Parlamentare është Partia Socialiste me 74 mandate;
- Pakica Parlamentare është Partia Demokratike (Aleanca për Ndryshim) 59 mandate;
- Lëvizja Socialiste për Integrim 4 mandate; dhe,
- Partia Socialdemokrate me 3 mandate.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 722 ka përcaktuar partitë që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-së. Konkretisht Partia Socialiste ka propozuar kryetarin e KZAZ-së dhe Partia e Lirisë ka propozuar zv.kryetarin e KZAZ-së. Referuar gjithmonë shkresës së Kuvendit të datës 24.01.2022, nuk ka parti politike dhe shumicë parlamentare që ka fituar në zgjedhjet për Kuvend e cila ka marrë të paktën dy mandate. Në këto kushte, propozimi për anëtarin e tretë të grupit të numërimit i takon Partisë Socialiste. Partitë politike të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.07.09.2023*

opozitës parlamentare që kanë fituar të paktën dy mandate në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021 dhe që është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës është Partia Demokratike. Në këto kushte, ku lista e partive të shumicës dhe pakicës parlamentare përmban vetëm një subjekt nuk do të ketë short për caktimin e antarit të tretë dhe të katërt. Për sa më sipër për të propozuar anëtarin e tretë të grupit të numërimit i takon në këtë rast partisë së vetme të shumicës parlamentare, Partisë Socisliste dhe e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të grupit të numërimit i takon partisë së pakicës parlamentare, Partisë Demokratike. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, atëherë sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve të 25 prillit 2021, Partisë Socialiste i takon e drejta e propozimit për anëtarin e parë të grupeve të numërimit, Partisë së Lirisë si parti e cila ka nënkryetarin e KZAZ-së i takon e drejta të propozojë anëtarin e dytë të grupit të numërimit. Meqenëse Partia Socialiste është partia e vetme e shumicës parlamentare i takon e drejta për të propozuar dhe anëtarin e tretë të grupeve të numërimit. Partisë Demokratike si parti e pakicës parlamentare i takon e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të grupeve të numërimit. Meqenëse Partia e Lirisë, e cila ka të drejtën për të propozuar anëtarin e dytë është e përjashtuar sipas ligjit nga e drejta për të patur ose për të marrë pjesë në shortin për caktimin e antarit të katërt. Pra, përbërja e grupit të numërimit do të jetë:

- dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste;
- një anëtar i propozuar nga Partia e Lirisë; dhe,
- anëtari i katërt i propozuar nga Partia Demokratike.

Mirë faleminderit çështje të tjera? Nuk kemi, seanca mbyllet.

**Vendimi nr. 766**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

